

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhment Financiar
Financial Management
(zgjidhjet)

P7

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

Do Not Open Until Your Invigilator Allows You to Do So.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

All Questions Are Mandatory

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

Time Allowed is 3 Hours

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Your name should appear nowhere in this test

Data: 08.10.2016

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA
1. Problemi 1	25	
2. Problemi 2	25	
3. Problemi 3	25	
4. Problemi 4	25	
Total	100	

Problemi 1

ABC mendon që është duke bërë mbitregtim. Informatat financiare të kompanisë janë prezantuar si në vijim:

	20X5		20X4	
	€000	€000	€000	€000
Shitjet me kredi		17,100		12,000
KMSH		8,550		7,500
Pasuritë qarkulluese				
Stoqet	2,500		2,100	
LL/A	2,000		1,000	
	-----		-----	
		4,500		3,100
Detyrimet qarkulluese				
LL/P	1,900		1,250	
Mbitërheqja	2,400		850	
	-----		-----	
		4,300		2,100
		-----		-----
Kapitali qarkullues neto		200		1,000
		-----		-----
Huatë afatgjata		3,000		3,000

Kompanitë të cilat janë të ngjashme me kompaninë ABC kanë këto mesatare për vitin 20x5:

Ditët në stoqe	65 ditë
Ditët në LL/A	30 ditë
Ditët në LL/P	50 ditë
Koeficienti qarkullues	1.7 herë
Koeficienti i shpejtë	0.8 herë
Supozoni 360 ditë në çdo vit.	

Kërkohet:

a) Vlerësoni nëse kompania 'ABC' është duke bërë mbi-tregtim si dhe diskutoni se si mbi-tregtimi mund të eliminohet. (20 pikë)

b) Shpjegoni se çka nënkuptoni me mbi-tregtim. (5 pikë)

(25 pikë)

Zgjidhje e problemit – 1

(a)

Për të dhëne përgjigje nëse ABC është duke mbi-tregtuar apo jo, duhet te merren për baze këta faktorë të mbi-tregtimit:

Rritja e shpejtë në të hyrat nga shitja

Mbi-tregtimi mund të rezultojë si pasojë e rritjes së shpejtë në të hyrat nga shitja e cila nuk përputhet në mënyrë proporcionale me rritjen në investimet në kapitalit qarkullues. Të hyrat nga shitja të ABC janë rritur me 42.5% brenda vitit, duke nënkuptuar një rritje të shpejtë në të hyrat nga shitja, ndërkaq raporti (koeficienti) i shitjeve ndaj neto kapitalit qarkullues është ngritur nga 12 herë në 86 herë, duke treguar që investimet në kapitalin qarkullues nuk janë përputhur me rritjen e të hyrave nga shitja.

Mbitregtimi gjithashtu mund të rezultojë si pasojë e mos zëvendësimit të borxhit afatgjatë i cili është ripaguar, por huaja afatgjatë e ABC nuk është ndryshuar. Mbi-tregtimi mund të paraqitet edhe nga inflacioni, sidoqoftë informatat në lidhje me inflacionin nuk janë prezantuar në këtë problem.

Rritja e mbështetjes në financimin afat-shkurtër

Ekziston evidencë e rritjes së mbështetjes së ABC në financimin afatshkurtër, pasi që mbitërheqja bankare është rritur me 182% (nga €850,000 në €2,400,000), ndërsa LL/P janë rritur me 52% (nga €1,250,000 në €1,900,000). Gjithashtu, proporcioni i pasurive afatshkurtra të financuara nga burimet afatshkurtra është rritur nga 68% në 96%. Sic është theksuar më herët, nuk ka pasur rritje në huazimet afatgjata të kompanisë ABC.

Rritja e shpejtë e pasurive afatshkurtra

Pasuritë afatshkurtra mund të rriten shpejtë në linjë me sasinë e shitjeve dhe të hyrat nga shitjet. LL/A janë rritur me €1,000,000 apo 100% në krahasim me periudhën paraprake. Sidoqoftë, stoqet janë rritur vetëm me 19% (nga €2,100,000 në €2,500,000), rritje kjo e cila është shumë më e vogël në krahasim me rritjen në të hyrat nga shitja.

Rënia në koeficientet e solvencës dhe likuiditetit

Koeficienti aktual i ABC ka rënë nga 1.5 herë në 1.05 herë, ndërsa koeficienti i shpejtë ka mbetur i pa ndryshueshëm në 0.5 herë. Të dy këta koeficiente janë nën mesataren e industrisë prej 1.7 herë dhe 0.8 herë respektivisht.

Tejkalimi i mbi-tregtimit

Mbi-tregtimi apo nën-kapitalizimi mund të tejkalohet duhet rritur kapitalin afatgjatë të kompanisë. Kjo mund të arrihet duhet marrë huazim të ri ose emetim të aksioneve (financim përmes ekuitetit). Në mënyrë alternative, mund të rikthehet balanca ndërmjet nivelit të aktivitetit të biznesit dhe shumës së financimit afatgjatë, për shembull duhet ngadalësuar rritjen e shpejtë të shitjeve derisa ABC të konsolidoj pozitën financiare të saj.

Analiza financiare

	20X5	20X4	Sektori
Ditët në stoqe			
360 x 2,500/8,550	105 ditët		
360 x 2,100/7,500		101 ditët	65 ditët
Ditët në LL/A			
360 x 2,000/17,100	42 ditët		
360 x 1,000/12,000		30 ditët	30 ditët
Ditët në LL/P			
360 x 1,900/8,550	80 ditët		
360 x 1,250/7,500		60 ditët	50 ditët
Koeficienti aktual			
4,500/4,300	1.05 herë		
3,100/2,100		1.5 herë	1.7 herë
Koeficienti i shpejtë			
2,000/4,300	0.5 herë		
1,000/2,100		0.5 herë	0.8 herë
Shitjet/Neto kapitali qarkullues			
17,100/200	86 herë		
12,000/1,000		12 herë	
Pasuritë afatshkurtra të financuara nëpërmjet financimit afatshkurtër			
20X5: 100 x 4,300/4,500	96%		
20X4: 100 x 2,100/3,100		68%	
Rritja e shitjeve: 17,100/12,000 = 42.5%			
Rritja e stoqeve: 2,500/2,100 = 19%			
Rritja e LL/A: 2,000/1,000 = 100%			
Rritja e LL/P: 1,900/1,250 = 52%			
Rritja e mbitërheqjes bankare: 2,400/850 = 182%			

(b)

E kundërta e mbi - kapitalizimit, mbi - tregtimi ndodh në rastet kur biznesi përpiket të bëjë shumë në një kohë shumë të shkurtër me shumë pak kapital afat - gjatë, duke u mundura kështu të mbështesë vëllime të mëdha të tregtisë me burimet kapitale në dispozicion. Edhe në rastet kur një biznesi i cili mbi - tregton operon duke realizuar fitime, gjasat janë të larta që biznesi të fillojë të ketë probleme serioze për arsye se nuk ka para të mjaftueshme. Probleme të tilla me likuiditetin dalin në pah prej faktit se biznesi nuk ka kapital të mjaftueshëm të paguajë më para të gatshme borxhet e veta, normalisht kur atyre iu vjen afati i pagimit.

Simptomat e mbi - tregtimit janë si vijon:

(a) Ka një rritje të shpejtë të qarkullimit.

(b) Ka një rritje të shpejtë në vëllimin e pasurive qarkulluese dhe me mundësi të madhe dhe në atë të pasurive fikse. Qarkullimi i stoqeve dhe qarkullimi i llogarive të arkëtueshme mund të ngadalësohen, rast në të cilin norma e rritjes së stoqeve dhe llogarive të arkëtueshme mund të jetë madje dhe më e madhe se sa norma e rritjes së shitjeve.

(c) Rritja e kapitalit të pronarëve është shumë e vogël (mbase me anë të fitimeve të pashpërndara). Shumica e rritjes së pasurive financohet prej kredive, sidomos prej:

- (i) Llogarive të pagueshme tregtare - periudha e pagesës së llogarive të pagueshme ka gjasa të zgjatet
- (ii) Mbitërheqjeve bankare [overdrafteve], të cilat shpesh arrijnë ose madje edhe kalojnë limitin e lejuar prej bankës
- (d) Ndryshimet dramatike të koeficientëve të borxhit dhe koeficientëve të likuiditetit.
- (i) pjesa e pasurive totale e cila financohet prej zvogëlimeve në kapitalin e pronarit, dhe pjesa e financuar prej rritjeve të kredive.
- (ii) Rënia e koeficientit qarkullues (korrent) dhe koeficientit të shpejtë (acid).
- (iii) Biznesi mund të ketë një deficit për sa i takon likuiditetit, që do të thotë, që detyrimet afat - shkurtra janë më të mëdha se sa pasuritë qarkulluese.

Problemi 2

ABC ka këtë strukturë të kapitalit:

	€000	€000
Ekuiteti		
Aksione të zakonshme	23,000	
Rezerva	247,000	270,000

Detyrimet afatgjata		
5% Aksionet preferenciale	5,000	
6% Notat kreditore	11,000	
Kreditë bankare	3,000	

		<u>19,000</u>
		<u>289,000</u>

Aksionet e zakonshme kanë një çmim aktual prej 4.26€ sipas parimit pa-dividendë dhe kanë vlerë nominale prej 0.25€ për aksion. Dividendat e zakonshme priten të rriten në të ardhmen për 4% në vit dhe dividendat prej 0.25€/aksion sapo është paguar.

Aksionet preferenciale kanë një vlerë të tregut pa-dividendë prej 0.56€ dhe vlerë nominale prej €1.00. Këto aksione janë jo të ribleshme.

Notat e pagueshme aktualisht tregtohen me €95.45 sipas parimit pa-interes dhe do të riblen me vlerën e tyre nominale prej €100/për notë kreditore pas pesë viteve

Kredia bankare ka një normë fikse të interesit prej 7% në vit. Tatimi në fitim është 25%.

Kërkohet:

- Kalkuloni koston mesatare të ponderuar të kapitalit pas tatimit për ABC duke marrë për bazë vlerat e tregut. (13 pikë)**
- Diskutoni ndërlidhjen ndërmjet kostove relative të burimeve të financimit dhe hierarkinë kreditore. (5 pikë)**
- Shpjegoni termet 'kosto mesatare e ponderuar e kapitalit' dhe 'kosto mesatare e ponderuar e kapitalit pas tatimit'. Në cilat raste përdoret e para dhe në cilat raste përdoret e dyta. (7 pikë)**

(25 pikë)

Zgjidhje e problemit – 2

(a) *Kosto e ekuitetit:*

Mund të aplikohet modeli i rritjes së dividendës për të kalkuluar koston e ekuitetit. $K_e = ((0.25 \times 1.04)/4.26) + 0.04 = 10.1\%$.

Kosto e aksioneve preferenciale:

$$K_p = (0.05 \times 1.00)/0.56 = 8.9\%$$

Kosto e notave kreditore:

$$\text{Pagesa vjetore e interesit pas tatimit} = 6 \times (1 - 0.25) = 6 \times 0.75 = \text{€}4.50/\text{vit}$$

Viti	Rrjedha e parasë (€)	5%	VT (€)	6%	VT (€)
0	(95.45)	1.000	(95.45)	1.000	(95.45)
1-5	4.50	4.329	19.48	4.212	18.95
5	100.00	0.784	78.40	0.747	74.70
			-----		-----
			2.43		(1.80)
			-----		-----

$$\text{Kosto e notave kreditore pas tatimit} = K_d = 5 + (1 \times 2.43)/(2.43 + 1.80) = 5 + 0.57 = 5.6\%$$

Kosto e kredisë bankare:

Norma e interesit pas tatimit mund të aplikohet si kosto e borxhit. Kjo do të jetë 5.25% (7×0.75). Në mënyrë alternative, kosto e notave kreditore pas tatimit mund të aplikohet si zëvendësues i koston së kredisë bankare pas tatimit.

Vlerat e tregut:

	€000
Ekuiteti: $4.26 \times (23,000,000/0.25) =$	391,920
Aksionet preferenciale: $0.56 \times (5,000,000/1.00) =$	2,800
Notat: $95.45 \times (11,000,000/100) =$	10,500
Kredia bankare	3,000

	408,220

KMPK (WACC) pas tatimit:

$$((10.1 \times 391,920) + (8.9 \times 2,800) + (5.6 \times 10,500) + (5.25 \times 3,000))/408,220 = 9.9\%$$

- (b) Hierarkia kreditore i referohet renditjes në bazë të së cilës të drejtat financiare mund të kërkohej nga kompania në rastin kur kompani falimenton. Hierarkia është si në vijim (sipas prioritetit rënës), kreditorët e siguruar, kreditorët e pasiguruar, aksionarët preferencial dhe aksionarët e zakonshëm. Rreziku i mos pranimi të parave gjatë likuidimit të kompanisë rritet me rënien e prioritetit. Kreditorët e siguruar (borxhi i siguruar) ballafaqohet me rrezikun më të ultë ndërsa ofruesit e financimit dhe aksionarët e zakonshëm ballafaqohen me rrezikun më të lartë.

Kthimi i pritur nga ofruesit e financimit varet nga rreziku me të cilin ata ballafaqohen. Kreditorët e siguruar kanë kërkesë për normë më të ultë të kthimit ndërsa aksionarët e zakonshëm kanë kërkesë për normë të lartë të kthimit. Kosto e borxhit duhet të jetë më e ultë se kosto e aksioneve preferenciale, e cila duhet të jetë më e ultë sesa kosto e ekuitetit.

- (c) Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit është kostoja mesatare e financimit të kompanisë (ekuitetit, fletë – obligacioneve, kredive bankare) e ponderuar sipas

përqindjes që zë secili element në rezervën totale të kapitalit. Kostoja e duhur e kapitalit që duhet të përdoret në vlerësimin e investimeve është kostoja marxhinale e fondeve të mbledhura (ose e të ardhurave të pashpërndara) për të financuar investimet. Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK / WACC) me sa duket është udhëzuesi mbi të cilin mund të mbështetemi më shumë për sa i takon llogaritjes së koston marxhinale të kapitalit, por vetëm duke supozuar se kompania vazhdon të investojë në të ardhmen, në projekte që kanë një nivel standard të rrezikut të biznesit, duke mbledhur fonde në përqindje të njëjta si struktura ekzistuese e kapitalit.

Kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit pas tatimit është ajo normë e cila është e përshtatur për efektin tatimor për secilin lloj të borxhit i cili ngërthen në vete normë të interesit.

Në rastet kur tatimet nuk mbahen parasysh për efekt të llogaritjes së rrjedhjeve të parasë, norma e skontimit do të duhet të pasqyrojë normën e kthimit para zbatimit të normës së tatimit e cila kërkohet për investimet kapitale, pra duhet aplikuar KMPK (WACC) para tatimit. Në rastet kur tatimet janë përfshirë në rrjedhjet e parasë, duhet të përdoret norma e kërkuar e kthimit pas zbatimit të tatimit, përkatësisht KMPK (WACC) pas tatimit.

Problemi 3

ABC është një kompani e cila merret me instalimin e kuzhinave dhe banjove për klientë të caktuar. Kompania është duke planifikuar të investoj €4,000,000 në një pajisje të re përmes të cilës do të krijoj produkte të reja për shitje. Produktet e reja të cilat priten të prodhohen dhe shiten:

Viti	1	2	3	4
Produktet e prodhuara dhe shitura	250	300	450	450

Çmimi i shitjes varet nga kualiteti i përbërësve të produktit. Në vijim është prezantuar tabela e produkteve të ndryshme të cilat do të prodhohen dhe shiten.

Lloji i produktit	Bazik	Standard	Deluks
Probabiliteti i shitjes	20%	45%	35%
Çmimi i shitjes (€/njësi)	30,000	42,000	72,000
Kostot e konvertimit (€/njësi)	23,000	29,000	40,000

Kostot fikse priten të varen nga volumi i njësive të prodhuara.

Volumi i prodhimit (njësi/vit)	200–299	300–399	400–499
Kostot fikse (€000/vit)	4,000	5,000	5,500

Tatimi në fitim është 28% në vit, ku obligimi tatimor paguhet në vitin në të cilin krijohet. Kompania regjistron si shpenzim të zhvlerësimit të lejuar për qëllime tatimore vlerën: vlera e investimit : 10 vite. Norma e skontimit pas tatimit për qëllime të vlerësimit të investimeve kapitale është 11%.

Kërkohet:

- Kalkuloni NVT-në e pritur të këtij investimit për katër vitet e para të operimit. (10 pikë)
- Pas vitit të 4-të, ABC pret të vazhdoj të prodhoj dhe shesë 450 njësi të produktit të ri në vit për një të ardhme të parashikueshme. *Kërkohet:* Kalkuloni efektin në NVT, të faktit që ABC do të vazhdoj të prodhoj dhe shesë këto produkte edhe pas vitit të 4-të. Komentoni mbi pranueshmërinë financiare të këtij investimi. (7 pikë)
- Diskutoni aplikimin e analizës së probabilitetit për inkuadrimin e rrezikut gjatë vlerësimit të projektit inventiv. (8 pikë)

(25 pikë)

Zgjidhje e problemit – 3

(a) Kalkulimi i NVT:

Viti	1	2	3	4
	€000	€000	€000	€000
Të hyrat nga shitja	12,525	15,030	22,545	22,545
Kostot e konvertimit	(7,913)	(9,495)	(14,243)	(14,243)
	-----	-----	-----	-----
Kontributi	4,612	5,535	8,302	8,302
Kostot fikse	(4,000)	(5,000)	(5,500)	(5,500)
	-----	-----	-----	-----
Rrjedha e parashë para tatimit	612	535	2,802	2,802
Tatimi në fitim 28%	(171)	(150)	(785)	(785)
Përfitimet e lejuara na shpenzimet e zhvlerësimit	112	112	112	112
	-----	-----	-----	-----
Rrjedha e parashë pas tatimit	553	497	2,129	2,129
Norma e skontimit 11%	0.901	0.812	0.731	0.659
	-----	-----	-----	-----
VT	498	404	1,556	1,403
	-----	-----	-----	-----
	€000			
VT total	3,861			
Investimi fillestar	4,000			

NVT	(139)			

Përlllogaritjet:

Çmimi mesatar i shitjes = $(30,000 \times 0.20) + (42,000 \times 0.45) + (72,000 \times 0.35)$
 = €50,100. Kosto mesatare e konvertimit për njësi = $(23,000 \times 0.20) +$
 $(29,000 \times 0.45) + (40,000 \times 0.35) = €31,650$ për njësi.

Viti	1	2	3	4
Volumi i shitjes (njësi/vit)	250	300	450	450
Çmimi mesatar i shitjes (€/unit)	50,100	50,100	50,100	50,100
	-----	-----	-----	-----
Te hyrat (€000/vit)	12,525	15,030	22,545	22,545
	-----	-----	-----	-----
Viti	1	2	3	4
Volumi i shitjes (njësi/vit)	250	300	450	450
Kosto mesatare e konvertimit (€/njësi)	31,650	31,650	31,650	31,650
	-----	-----	-----	-----
Kosto e konvertimit (€000/vit)	7,913	9,495	14,243	14,243
	-----	-----	-----	-----

Kontributi mund të përlllogaritet në mënyrë direkte. Kontributi mesatar = $50,100 - 31,650 = €18,450$ për njësi.

Viti	1	2	3	4
Volumi i shitjes (njësi/vit)	250	300	450	450
Kontributi mesatar (€/njësi)	18,450	18,450	18,450	18,450
	-----	-----	-----	-----
Kontributi (€000/vit)	4,613	5,535	8,303	8,303
	-----	-----	-----	-----

Zhvlerësimi i lejuar për qëllime tatimore = $4,000,000/10 = €400,000$ për vit

Përfitimet nga zhvlerësimimi i lejuar = $400,000 \times 0.28 = €112,000$ për vit

- (b) Duke injoruar zhvlerësimin e lejuar, rrjedha e parasë pas tatimit nga viti i pestë dhe tutje do të jetë: $2,802,000 - 785,000 = €2,017,000$ për vit. PV e kësaj rrjedhje të parasë në pafundësi do të jetë:
 $= (2,017,000/0.11) \times 0.659 = €12,083,664$. Do të rezultojnë edhe gjashtë vite me përfitime nga zhvlerësimi i lejuar tatimor. PV e kësaj rrjedhje të parasë do të jetë: $112,000 \times 4.231 \times 0.659 = €312,282$.

Rritja në NVT nga prodhimi dhe shitja pas katër viteve të para do të jetë $12,083,664 + 312,282 = €12,395,946$ ose €12.4 milion.

Nëse merren parasysh vetëm katër vitet e para të operimit, NVT e investimit është negative dhe investimi nuk është financiarisht i pranueshëm. Nëse prodhimi dhe shitja vazhdojnë edhe pas vitit të katërt, NVT është pozitive dhe investimi është i pranueshëm. Në fakt, NVT bëhet pozitive vetëm nëse merret në konsideratë edhe një vit shtesë. $NVT = (2,129,000 \times 0.593) - 139,000 = 1,262,497 - 139,000 = €1,123,497$

- (c) Rreziku gjatë vlerësimit të projekteve investive i referohet një rangui të outputeve probabiliteti i të cilave mund të kuantifikohet. Prandaj rreziku duhet të dallohet nga pasiguria, gjatë vlerësimit të projekteve investimve, ku në rastin e pasigurisë, probabiliteti i outputit nuk mund të kuantifikohet.

Sa i përket, përfshirjes së rrezikut në vlerësimet investive, analiza e probabilitetit mund të aplikohet për të llogaritur vlerat e outputeve potenciale dhe shpërndarjen e probabilitetit të tyre, vlerën më të keqe të mundshme dhe probabilitetin e saj, probabilitetin që investimi do të gjeneroj NVT pozitive, devijimin standard të outputeve të mundshme dhe vlerat e pritura (vlerat mesatare) të NVT-së. Devijimi standard është masë e matjes së rrezikut në fishën e menaxhimit financiar.

Një vështirësi me analizën e probabilitetit është supozimi që një investim mund të përsëritet disa herë. Vlera e pritur e NVT-së, p.sh., është mesatare e një numri të NVT-ve potenciale, ndërsa devijimi standard është masë e dispersionit të NVT-ve potenciale rreth NVT-së të pritur (mesatare). Në realitet, shumë projekte investive nuk mund të përsëriten dhe si rezultat vetëm një nga alternativat e mundshme realisht do të ndodhë. Vlera e pritur (mesatare) realisht nuk do të ndodhë, duke shkaktuar vështirësi në aplikimin dhe interpretimin e rregullës për pranimin e NVT-së gjatë aplikimit të analizës së probabilitetit.

Një vështirësi tjetër me analizën e probabilitetit është pyetja se si vlerësohen dhe kalkulohen probabilitetet e outputeve potenciale. Një metodë e përcaktimit të probabilitetit është duke marrë në konsideratë dhe analizuar outputet (rezultatet) e investimeve të ngjashme nga e kaluara. Sidoqoftë, kjo qasje mbështetet në supozime të dobëta që e kaluara është udhëzuesi i pranueshëm për të ardhmen. Vlerësimi i probabilitetit në këtë mënyrë është gjithashtu një proces mjaft subjektiv.

Problemi 4

(I)

Vlera mesatare e llogarive të arkëtueshme tregtare të një kompanie është € 1.50 milion për një qakullim prej € 10.95 milionësh. Menaxheri i kontrolleve mbi kreditimet është duke marrë në konsideratë ofrimin e një zbritjeje prej 1% për pagesën brenda për brenda 10 ditëve; ai beson se 30% e klientëve do të përdorin këtë ofertë. Drejtori i financave ka dyshime serioze dhe nuk mendon se zbritja do të jetë efektive për sa i takon kostove. Kompania fiton interes mbi tepricat e tepërta të parasë së gatshme me një normë vjetore prej 2.5%.

Kërkohet:

- a) A do të jetë efektive për sa i takon kostove një zbritje prej 1%? (5 pikë)
- b) Cilat janë supozimet që keni bërë për të arritur tek ky konkluzion? (4 pikë)
- c) Çfarë këshillash do të ofronit? (4 pikë)

(a)

Hapi një: Përcaktimi i kostos vjetore të ofrimit të zbritjes:

$$€ 10.95 \text{ milion} \times 30\% \times 1\% = € 0.03285 \text{ milion} = € 32,850$$

Hapi dy: Përcaktimi i përfitimit nga ofrimi i zbritjes:

Periudha aktuale e mbledhjes së llogarive të arkëtueshme (PMLLA) është:

$$= € 1.5 \text{ milion} \div € 10.95 \text{ milion} \times 365 \text{ ditë}$$

$$= 50 \text{ ditë}$$

Në qoftë se 30% e klientëve me kredi paguajnë për 10 ditë atëherë PMLLA – ja e re do të jetë:

$$= (10 \text{ ditë} \times 30\%) + (50 \text{ ditë} \times 70\%)$$

$$= 38 \text{ ditë}$$

Shifra e re mesatare e llogarive të arkëtueshme pas zbritjes do të jetë:

$$= 38 \text{ ditë} \times € 10.95 \text{ milion} \div 365$$

$$= € 1.14 \text{ milion}$$

Ky është një reduktim i shifrës aktuale të llogarive të arkëtueshme me:

$$= € 1.50 \text{ milion} - € 1.14 \text{ milion}$$

$$= € 0.36 \text{ milion}$$

Interesi i fituar mbi këtë tepricë të reduktuar të llogarive të arkëtueshme do të jetë:

$$= € 0.36 \text{ milion} \times 2.5\%$$

$$= € 0.009 \text{ milion}$$

$$= € 9,000$$

Hapi tre: Krahasoni i kostove me përfitimet:

Kostot janë më të mëdha se sa përfitimet si:

$$= € 32,850 - € 9,000$$

$$= € 23,850$$

Dhe kështu zbritja e propozuar për pagesa para ardhjes së afatit nuk do të jetë efektive për sa i takon kostove.

(b)

Llogaritjet më sipër përfshijnë supozimet e mëposhtme:

- 30% si përqindja e vlerësuar e kreditorëve që do të përfitojnë nga zbritja është e saktë; duhet ofrohen evidenca që tregojnë se kjo është e vërtetë;
- Kreditorët që përfitojnë nga zbritja përfaqësojnë në mënyrë tipike të gjithë popullatën e klientëve, gjë që do të thotë që kreditorët që nuk përfitojnë nga zbritja do të paguajnë përsëri mesatarisht brenda 50 ditëve;
- Paraja e gatshme që do të arkëtohet më herët si rezultat i zbritjes do të investohet e gjitha për të fituar 2.5% për të gjitha 38 ditët që pagesa bëhet më herët;
- Të gjithë klientët që përdorin zbritjen do të paguajnë të gjithë mesatarisht në brenda 10 ditëve.

(c)

Këshilla më e mirë për këtë kompani është të mos ofrojë zbritjen prej 1%.

Madje edhe në qoftë se 100% e debitorëve e përdorin zbritjen e ofruar, interesi shtesë i fituar do të jetë vetëm € 30,000 (shikoni llogaritjet më poshtë), që nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar kostot.

Megjithatë, periudha e pagesës prej 50 ditësh përfaqëson një kosto për biznesin dhe duhet të reduktohet, gjithmonë në rast se kjo mund të jetë bëhet në një mënyrë efektive për sa i takon kostove dhe pa i larguar klientët e mirë. Një qasje e mundur mund të jetë:

- Përmirësimi i procedurave të kontrollit të kreditimit të klientëve dhe dokumentimi i tyre, ose
- Punësimi i palëve të jashtme për kryerjen e shërbimeve të menaxhimit të llogarive të arkëtueshme.

Llogaritjet:

Një periudhë mesatare 10 ditore e pagesës për të gjithë klientët rezulton në një shifër të llogarive mesatare të arkëtueshme prej

$$= 10 \text{ ditë} \times € 10.95 \text{ milion} \div 365$$

$$= € 0.3 \text{ milion}$$

Ky është një reduktim i shifrës aktuale të llogarive të arkëtueshme prej:

$$= € 1.50 \text{ milion} - € 0.3 \text{ milion}$$

$$= € 1.2 \text{ milion}$$

Interesi i fituar nga reduktimi i tepricës së llogarive të arkëtueshme do të jetë:

$$= € 1.2 \text{ milion} \times 2.5\%$$

$$= € 0.03 \text{ milion}$$

$$= € 30,000$$

(II)

Një kompani furnitore është duke shqyrtuar ofrimin e një zbritjeje prej 4% për pagesat që bëhen brenda për brenda dhjetë ditëve për një klient me të cilin bashkëvepron rregullisht. Klienti normalisht paguan brenda 30 ditëve. Tepricat e papërdorura të parasë së gatshme investohen me 0.06% në ditë (interesi i përbërë). Kompania furnitore po përgatitet të lëshojë një faturë me vlerë për € 1,000 ndaj këtij klienti.

Kërkohet:

a) A ia vlen nga ana financiare të ofrohet kjo zbritje? Çfarë këshille do të jepnit? (4 pikë)

Hapi 1: Përcaktimi i kostos së ofrimit të zbritjes:

Zbritja e propozuar është 4% e faturës prej € 1,000, do të thotë € 40.

Hapi 2: Përcaktimi i përfitimit nga ofrimi i zbritjes:

Kursimet që do të jenë € 960 do të arkëtohen 20 ditë më herët se sa zakonisht, dhe kështu interesi i fituar do të jetë:

$$= € 960 \times (1.0006^{20} - 1)$$

$$= € 960 \times 0.012$$

$$= € 11.52$$

Hapi 3: Krahasoni i kostove me përfitimet:

Kostoja e zbritjes është € 40 ndërsa përfitimi prej zbritjes është vetëm € 11.52, gjë që sugjeron se furnitori do të humbasë € 28 në qoftë se ofron këtë zbritje.

Këshilla:

Nuk këshillohet të ofrohet një zbritje meqenëse do të kushtojë më shumë se sa kursehet si përfitim nga interesi.

Një zbritje prej 1% (€ 10) ose më pak ia vlen, por shumat monetare që kursehen do të jenë shumë të vogla, dhe kështu mund të mos jetë me leverdi për shkak të kostove shtesë të administratës.

Vini re:

Kjo llogaritje ka të bëjë me një faturë specifike dhe prandaj është më e thjeshtë se sa shembull i zgjidhur i treguar më herët, i cili ka të bëjë me 40% të llogarive të arkëtueshme të një organizate për të gjithë vitin.

Mund të keni vënë re se norma ditore e interesit me vlerë 0.06% që mund të fitohet nga paratë e gatshme të arkëtuara më herët është në fakt shumë më e lartë se realiteti; ajo është e barabartë me një normë vjetore prej më shumë se 24%.

$$(1.0006^{365} - 1) = 0.2447 = 24.5\%.$$

(III)

Paranojaku sh. p. k. është një furnitor me shumicë i materialeve për zyra, me shitje vjetore me kredi që vlerësohet se janë € 30 milion ndërsa teprica e pritshme e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit pritet të jetë € 7.5 milion. Kompania dëshiron të dijë për sa i takon faktit nëse duhet apo nuk duhet të ofrojë një zbritje prej 2% për pagesat që bëhen brenda për brenda 30 ditëve

për të inkurajojuar pagesat e hershme. Hulumtimi ka treguar se ka një probabilitet prej 20% që 30% e debitorëve të përdorin zbritjen, një probabilitet prej 40% që 40% e debitorëve të përdorin zbritjen dhe një probabilitet prej 40% që 50% e debitorëve të përdorin zbritjen për pagesat e bëra para ardhjes së afatit. Kompania aktualisht paguan 8% interes për mbitërheqjet e saj bankare.

Kërkohet:

a) A do të propozonit se zbritja përfaqëson një vlerë të mirë të përfutur për paratë e shpenzuara – pra ia vlen apo jo të jepet? (8 pikë)

(25 pikë)

Së pari, do të duhet të llogaritim periudhën aktuale të mbledhjes së llogarive të arkëtueshme duke pjesëtuar vlerën e borxheve me vlerën e shitjeve totale dhe duke e shumëzuar atë me numrin e ditëve në një vit. Kështu supozojmë se borxhet e papaguara do të mbeten relativisht konstante gjatë të gjithë vitit.

$$7.5 \text{ milion} \div 30 \text{ milion} \times 365 = 91.25 \text{ ditë}$$

Më pas do të duhet të llogaritim periudhën e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme në qoftë se ofrohet një zbritje. Duke përdorur probabilitetet, përqindja e pritshme e debitorëve që do të përfitojnë nga zbritja është 42%.

$$(30\% \times 20\%) + (40\% \times 40\%) + (50\% \times 40\%) = 42\%$$

Nga llogaritjet më sipër supozojmë se në qoftë se ofrohet një zbritje, 42% e borxhlinjve do të paguajnë brenda 30 ditëve ndërsa pjesa e mbetur prej 58% ende do të paguajnë pas 91.25 ditësh. Pra, në qoftë se zbritja ofrohet, kjo jep një mesatare të ponderuar të periudhës së mbledhjes së llogarive të arkëtueshme prej:

$$= 30 \text{ ditë} \times 42\% + 91.25 \text{ ditë} \times 58\%$$

$$= 65.525 \text{ ditë}$$

Mbi këto baza, totali i llogarive të arkëtueshme do të jetë:

$$= 65.525 \text{ ditë} \div 365 \text{ ditë} \times € 30 \text{ milion} = € 5.386 \text{ milion}$$

(Kjo llogaritje është bërë duke përmbytur formulën për llogaritjen e periudhës së mbledhjes së llogarive të arkëtueshme).

Kursimet e interesit mund të llogariten më pas si diferenca midis tepricës së llogarive të arkëtueshme në fund të vitit, për të dyja rastet, pra nëse ofrohet zbritja ose nëse nuk ofrohet ajo.

$$(€ 7.5 \text{ milion} - € 5.386 \text{ milion}) \times 8\% = € 169,120$$

Tani kemi nevojë të krahasojmë kursimet e interesit me koston e ofrimit të zbritjes. Kostoja është llogaritur si 42% e të gjithë klientëve që vlerësohet se do të përdorin zbritjen prej 2%:

$$2\% \times 42\% \times € 30 \text{ milion} = € 252,000$$

Në këtë mënyrë kostoja neto e zbritjes është:

$$= € 252,000 - € 169,120 = € 82,880$$

Kjo shifër sugjeron se zbritja e propozuar nuk do të jetë efektive për sa i takon kostove.

Këto përfundime janë të gjitha të pasigurita në fakt meqenëse ato bazohen mbi një nivel 'të pritshëm' të përdorimit të zbritjes, si 42%. Megjithatë, madje në qoftë se do të dilte në pah rezultati më i mirë i mundshëm, pra sikur 50% e borxhlinjve të përdornin zbritjen – kursimet do të ishin ende vetëm € 201,370, e cila është përsëri më pak se sa kostoja.